REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINACAVE DHE EKONOMISË
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

# SKELETKURRIKULI

## Për Profilin Mësimor

# PRODHIM BIMOR

## Niveli III i KSHK
## (1-vjeçar)

## (Në drejtimin mësimor "Bujqësi")

**Kodi: H6-III-20**

Miratoi.

MINISTRI

**Tiranë, 2020**

## Përmbajtja.


**I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Prodhim bimor”, niveli III i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), të drejtimit mësimor “Bujqësi”.**

**II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Prodhim bimor”, niveli III i KSHK.**

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Prodhim bimor”, niveli III i KSHK
2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Prodhim bimor”, niveli III i KSHK
3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Prodhim bimor”, niveli III i KSHK
4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit në në profilin “Prodhim bimor”, niveli III i KSHK.

**III. Plani mësimor për profilin “Prodhim bimor”, niveli III i KSHK.**

**IV. Udhëzime për planin mësimor**

**V. Udhëzime për procesin mësimor.**

**VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.**

**VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit në profilin “Prodhim bimor”, niveli III i KSHK.**

**VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.**

**IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.**

**X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar.**

## I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin "Prodhim bimor", niveli III i KSHK, të drejtimit "Bujqësi".

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në profilin "Prodhim bimor" niveli III i KSHK, të drejtimit "Bujqësi", është *"zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t'u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me prodhimin bimor"*. Për të realizuar këtë, shkolla profesionale u krijon nxënësve.

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë.
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehitë, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtejshëm.
- mbështetje për t'u njohur me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t'i zbatuar ato me rreptësi.
- mbështetje për t'u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës.
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse, si dhe vlerat morale.
- mbështetje për t'u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale.
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

## II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profili "Prodhim bimor", niveli III i KSHK.

### 1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin mësimor "Prodhim bimor", niveli III i KSHK

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në profilin mësimor "Prodhim bimor" niveli III i KSHK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që.

- kanë mbaruar arsimin profesional në drejtimin mësimor "Bujqësi", niveli II të KSHK.
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- kanë aftësi të kufizuara, për të cilët shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitet reale të këtyre shkollave, atëherë, MFE përgatit udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.

### 2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim arsimit në profilin mësimor "Prodhim bimor", niveli III i KSHK

Në përfundim të arsimit profesional në profilin profesional "Prodhim bimor", niveli III i KSHK, nxënësi do të zotërojë këto kompetenca të përgjithshme kryesore.

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.

- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efiçente.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integrimeve lokale, rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënit të tij dhe të shfaqë gadishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuara.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

**3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin mësimor "Prodhim bimor", niveli III i KSHK.**

Në përfundim të arsimit profesional në profilin profesional "Prodhim bimor", niveli III i KSHK, nxënësi do të jetë i aftë të zhvillojë më tej kompetencat profesionale të fituara në nivelin II të KSHK, si dhe të ushtrojë kompetenca të tjera profesionale, si më poshtë.

- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me veprimtaritë profesionale të prodhimit bimor.
- Të bëjë organizimin e vogël të punës në punimet që lidhen me prodhimin bimor.
- Të interpretojë, plotësojë dhe përgatisë dokumentacionin teknik të prodhimit bimor.
- Të zbatojë standardet e profesionit që lidhen me punimet dhe shërbimet në prodhimin bimor.
- Të përgatisë tokën për mbjelljen e kulturave të ndryshme të arave.
- Të kryejë mbjelljen e kulturave të ndryshme të arave.
- Të kryejë shërbimet agroteknike ndaj kulturave të ndryshme të arave.
- Të kryejë vjeljen dhe ruajtjen e prodhimit të kulturave të ndryshme të arave.
- Të zbatojë rregullat e sigurisë në punë e të mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punëve dhe shërbimeve në prodhimin bimor.

## III. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor "Prodhim bimor", niveli III i KSHK.

Përfundimi me sukses i arsimit profesional në profilin "Prodhim bimor", niveli III i KSHK, e pajis nxënësin me certifikatën e punonjësit të kualifikuar në këtë profil profesional. Ky arsimim i jep mundësi nxënësit t'i drejtohet tregut të punës për t'u punësuar në ndërmarrje publike ose biznese private të prodhim bimorsë, ferma të ndryshme të prodhimeve bujqësore, si dhe për t'u vetëpunësuar në veprimtari që lidhen me prodhim bimornë. Mbas një përvoje pune dhe trajnimeve të mëtejshme, ai mund të krijojë një biznes të vogël në punimet dhe shërbimet që kryhen në fushën e prodhim bimor dhe të punësojë të tjerë në të.
Me përfundimin e këtij niveli, nxënësi ka mundësi për vazhdimin e arsimimit në nivelin IV të KSHK (teknik/manaxherial) të arsimit profesional (njëvjeçar) në drejtimin "Bujqësi", për të fituar diplomën e "Maturës shtetërore profesionale", me mundësi për vazhdimin e studimeve universitare.

## III. Plani mësimor për arsimin profesional në profilin mësimor "Prodhim bimor", niveli III i KSHK

| Plani mësimor për profilin mësimor "Prodhim bimor", niveli III i KSHK | | | |
|---|---|---|---|
| **Nr** | **Kodi** | **Lëndët dhe modulet mësimore** | **Orët javore/ vjetore** |
| | | | **Klasa 12** |
| **A.** | | **Lëndët e përgjithshme** (Gjithsej) | **8/9** (272/306) |
| 1 | | Gjuhë shqipe | 1 |
| 2 | | Letërsi | 1 |
| 3 | | Gjuhë e huaj e parë | 2 |
| 4 | | Gjuhë e huaj e dytë (me zgjedhje të lirë) | (1) |
| 5 | | Matematikë | 2 |
| 6 | | TIK | 1 |
| 7 | | Edukim fizik, sporte, shëndet | 1 |
| **B.** | | **Lëndët profesionale** (Gjithsej) | **7 (238)** |
| 1 | L-17-157-20 | Bazat e sipërmarrjes | 2 |
| 2 | L-14-533-20 | Prodhim bimor | 4 |
| 3 | L-14-332-20 | Përpunimi i prodhimit bimor | 1 |
| **C.** | | **Module të detyruar të praktikës profesionale** (Gjithsej) | **12 (408)** |
| 1 | M-14-1648-20 | Përgatitja e tokës për mbjelljen e kulturave të arave | 102 |
| 2 | M-14-1649-20 | Mbjellja e kulturave të arave | 120 |
| 3 | M-14-1650-20 | Kryerja e shërbimeve agroteknike ndaj kulturave të arave | 102 |
| 4 | M-14-1651-20 | Vjelja dhe ruajtja e prodhimit bimor | 51 |
| 5 | M-14-945-20 | Vlerësimi i materialit bimor për prodhimtari | 33 |
| **D.** | | **Modulet e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar** (Gjithsej) | **3 (102)** |
| 1 | M-14-946-20 | Analizimi i cilësive të farës për mbjellje | 51 |
| 2 | M-08-1652-20 | Prodhimi i vajit nga kulturat vajore | 51 |
| 3 | M-14-947-20 | Ujitja e bimëve të arave dhe perimeve | 51 |
| 4 | M-14-1653-20 | Prodhimi i farës së perimeve | 51 |
| | | **Gjithsej A+B+C+D** | **30/31** (1020/ 1054) |

## IV. Udhëzime për planin mësimor

Në klasën 12, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (34 javë mësimore + 2 javë provime)
Një javë mësimore ka jo më shumë se 31 orë mësimore (teorike dhe praktike).
Një orë mësimore zgjat 45 minuta.
Kurrikuli i arsimit profesional në profilin "Prodhim bimor", niveli III i KSHK, përbëhet nga 4 grupe elementesh kurrikulare.

– Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për profilet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MASR).
– Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithëshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
– Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
– Modulet e praktikave profesionale me zgjedhje të detyruar (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

## V. Udhëzime për procesin mësimor.

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin te ta, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme.
E rëndësishme është që ***planifikimi i mësimdhënies*** të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integrimit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.
Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi i nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.
Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i "të nxënit duke bërë" duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të profilit mësimor "Prodhim bimor", niveli III i KSHK.
Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathtësitë dhe shprehitë praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimit (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi.
Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të profilin profesional "Prodhim bimor".

## VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.
Në përfundim të klasës së 12-të, nxënësi i arsimuar në profilin mësimor "Prodhim bimor", niveli III i KSHK, i nënshtrohet provimeve të mëposhtme.

a) Provimi i teorisë profesionale të integruar.
b) Provimi i praktikës profesionale të integruar.
Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit të kompetencave profesionale (njohurive, shprehive, vlerave dhe qëndrimeve), të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën e ndërtimit, dhe u jepet certifikata në të cilën evidentohen notat përfundimtare të lëndëve teorike profesionale, të moduleve të praktikës profesionale, të lëndëve të përgjithshme, si dhe rezultatet e dy provimeve përfundimtare të nivelit III të KSHK.

## VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor "Prodhim bimor", niveli III i KSHK.

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në profilin mësimor "Prodhim bimor", niveli III i KSHK, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Dëftesën e përfundimit të këtij niveli si dhe me Certifikatën e aftësimit profesional, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modelit të miratuar nga MFE, këto dëshmi përmbajnë.
a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar, etj.
b) Të dhëna për rezulatet e arrritura nga nxënësi.
- rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale,
- rezultatet e dy provimeve përfundimtare të Nivelit III të KSHK.

## VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

### 1. Lënda "Bazat e sipërmarrjes" (L-17-157-20). Kl. 12 – 68 orë

- **Synimet e lëndës "Bazat e sipërmarrjes", kl. 12.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës "Bazat e sipërmarrjes", kl.12, nxënësit duhet:
- të përshkruajnë kuptimin, rëndësinë dhe rolin e sipërmarrjes në kontektin individual dhe shoqëror
- të përshkruajnë veçoritë e sjelljes sipërmarrëse të individëve
- të analizojnë aftësitë dhe mundësitë personale në kontektin e nismave sipërmarrëse
- të bëjnë vlerësimin e kërkesave, dëshirave, mundësive dhe vështirësive të tyre për karrierën e ardhëshme
- të zbatojnë procedurat për zgjidhjen e problemeve dhe marrjen e vendimeve të duhura në lidhje me to.
- të mbajnë qëndrim kritik dhe krijues ndaj zgjidhjeve të bëra, sukseseve dhe dështimeve të mundshme
- të përshkruajnë dhe zbatojnë parimet e etikës së komunikimit dhe negocimit në kontekste të ndryshme jetësore
- të përshkruajnë dhe zbatojnë parimet e punës individuale dhe të punës në grup
- të analizojnë veçoritë e gatishmërisë, iniciativës dhe motivimit në kontekste të ndryshme jetësore
- të tregojnë përgjegjësi individuale dhe shoqërore në kontekste të ndryshme jetësore
- të planifikojnë, sigurojnë dhe përdorin me efiçiencë burimet e ndryshme si mjedisin, burimet njerëzore, paratë, kohën etj.
- të përshkruajnë veçoritë dhe kërkesat për udhëheqjen e sipërmarrjeve të ndryshme
- të përshkruajnë veçoritë dhe impaktin e globalizimit, informacionit, mjedisit dixhital dhe mediave sociale në shoqërinë e sotme dhe të së ardhmes
- të përshkruajnë veçoritë e sipërmarrjes së biznesit dhe të sipërmarrjes sociale
- të përshkruajnë format e ndryshme të organizimit të sipërmarrjeve dhe karakteristikat e tyre
- të analizojnë faktorët që ndikojnë në veprimtarinë e sipërmarrjeve, të tillë si tregjet, klientela, konkurenca, kostot etj.
- të përshkruajnë mjedisin ligjor dhe fiskal të sipërmarrjeve
- të përshkruajnë mërrëdhëniet e punës në një sipërmarrje.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës "Bazat e sipërmarrjes", kl.12 - 68 orë**

| | | |
|---|---|---|
| **Tema 1** | Kuptimi, rëndësia dhe roli i sipërmarrjes | 3 orë |
| **Tema 2** | Aftësitë dhe sjellja sipërmarrëse | 3 orë |
| **Tema 3** | Vetvlerësimi i potencialit personal | 3 orë |
| **Tema 4** | Vlerësimi i kërkesave, dëshirave, mundësive dhe vështirësive | 4 orë |
| **Tema 5** | Zgjidhja e problemeve dhe vendimmarrja | 4 orë |
| **Tema 6** | Qëndrimi kritik dhe krijues ndaj zgjidhjeve të bëra, sukseseve dhe dështimeve | 3 orë |
| **Tema 7** | Etika e komunikimit dhe negocimit | 4 orë |
| **Tema 8** | Puna individuale dhe puna në grup | 4 orë |

| | | |
|---|---|---|
| **Tema 9** | Gatishmëria, iniciativa dhe motivimi | 3 orë |
| **Tema 10** | Përgjegjësia individuale dhe shoqërore | 3 orë |
| **Tema 11** | Menaxhimi efiçient i burimeve | 3 orë |
| **Tema 12** | Aftësitë udhëheqëse në kontekstin e sipërmarrjes | 3 orë |
| **Tema 13** | Globalizimi, informacioni, mjedisi dixhital dhe mediat sociale | 5 orë |
| **Tema 14** | Sipërmarrja e biznesit dhe sipërmarrja sociale | 3 orë |
| **Tema 15** | Format e organizimit të sipërmarrjeve | 5 orë |
| **Tema 16** | Konteksti i sipërmarrjeve, tregjet, klientela, konkurenca, kostot etj. | 6 orë |
| **Tema 17** | Mjedisi ligjor i sipërmarrjeve | 5 orë |
| **Tema 18** | Marrëdhëniet e punës | 4 orë |

## 2. Lënda "Prodhim bimor" (L-14-533-20). Kl. 12 –136 orë

- **Synimet e lëndës "Prodhimi bimor", kl. 12.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës "Prodhim bimor", kl.12, nxënësit duhet.

- Të përshkruajnë vlerat ekonomike dhe rëndësinë që ka prodhimi bimor në ekonominë e vendit.
- Të bëjnë dallimin midis sistemeve të ndryshme si: sistemi natyral, tradicional, intensiv, dhe organik i prodhimit bimor.
- Të përshkruajnë strukturën, karakteristikat e kultivarëve të grurit, si dhe veçoritë e kultivimit të grurit sipas zonave klimatiko-tokësore.
- Të përshkruajnë rolin dhe qëllimet e prodhimit të thekrës, elbit dhe tërshërës në ditët e sotme.
- Të përshkruajnë veçoritë e prodhimit të tritikaleve, tepës dhe okrës.
- Të përshkruajnë strukturën e hibrideve të misrit, karakteristikat e tyre dhe veçoritë e kultivimit të tyre sipas zonave klimatiko-tokësore.
- Të përshkruajnë agroteknologjinë e kultivimit të misrit hamullor.
- Të përshkruajnë specifikat e sëmundjeve dhe dëmtuesve kryesorë drithërave, si dhe masat e luftimit ndaj tyre.
- Të theksojnë momentet kryesore të agroteknologjisë së kultivimit të orizit.
- Të përshkruajnë strukturën e bishtajoreve për kokërr, llojet e fasules që kultivohen në vendin tonë.
- Të përshkruajnë kultivimin e fasules për kokërr sipas zonave klimatiko-tokësore në vendin tonë, si dhe mënyrat e kultivimit të fasules të bashkëshoqëruar.
- Të përshkruajnë veçoritë e kultivimit të sojës krahasuar me fasulen.
- Të përshkruajnë veçoritë e kultivimit të bathës, bizelës, qiqrës dhe thjerrëzës.
- Të përshkruajnë sëmundjet dhe dëmtuesit e bimëve bishtajore, si dhe masat e luftimit ndaj tyre.
- Të përshkruajnë veçoritë e kultivimit të bimëve industriale vajore si luledielli, kikiriku, recini dhe susami.
- Të përshkruajnë veçoritë e kultivimit të bimëve industriale sheqerore si panxhari i sheqerit.
- Të përshkruajnë tipet, llojet, karakteristikat e llojeve, cilësitë fiziko-kimike të duhanit dhe veçoritë e kultivimit të tij sipas zonave klimatiko-tokësore.

- Të përshkruajnë mënyrat e tharjes dhe të manipulimit të prodhimit të duhanit.
- Të përshkruajnë veçoritë e kultivimit të bimëve industriale fijore si pambuku, liri dhe kërpi.
- Të përshkruajnë qëllimin e kultivimit, klasifikimin e bimëve aromatike, sipas përdorimit dhe ndikimin e faktorëve mjedisor në prodhimin e tyre.
- Të përshkruajnë procesin e mbledhjes, tharjes dhe përpunimit paraprak të bimëve aromatike.
- Të përshkruajnë bimët aromatike kryesore që përdoren në farmaceutikë si angjelika, bar blete, valeriana, kamomili, luletogëza, timusi, pelini, trëndafili i egër etj.
- Të përshkruajnë bimët aromatike kryesore që përdoren për erëza si rigoni, trumëza, koriandri, anisi, barbaroza, borziloku, menta, shëngjini etj.
- Të përshkruajnë bimët aromatike kryesore që përdoren në kozmetikë si lavanda, trëndafili i damaskut etj.
- Të përshkruajnë specifikat e sëmundjeve dhe dëmtuesve kryesorë të bimëve industriale dhe aromatike si dhe masat e luftimit ndaj tyre.
- Të krahasojnë veçoritë e kultivimit të kulturave perimore kryesore për frute sipas grup familjeve.
- Të krahasojnë veçoritë e kultivimit të kulturave perimore kryesore për gjethe dhe kërcell sipas grup familjeve.
- Të krahasojnë veçoritë e kultivimit të kulturave perimore kryesore për frutrrënjor sipas grup familjeve.
- Të krahasojnë veçoritë e kultivimit të kulturave perimore kryesore për lule si lulelakra, brokoli.
- Të krahasojnë veçoritë e kultivimit të kulturave perimore kryesore për bishtajë si mashurka, batha, vinja etj.
- Të përshkruajnë sëmundjet dhe dëmtuesit e perimeve, si dhe masat e luftimit ndaj tyre.
- Të përshkruajnë kultivarët e patates që mbillen në vendin tonë, veçoritë e kultivimit sipas zonave, mbjelljen verore të saj, degjenerimin e patates, si dhe mënyrat e ruajtjes së prodhimit të patates.
- Të përshkruajnë sëmundjet dhe dëmtuesit e patates, si dhe masat e luftimit ndaj tyre
- Të hartojnë vargëzimin e prodhimit perimor për gjatë gjithë vitit.
- Të përshkruajë veçoritë e prodhimit foragjerë si dhe bimët foragjere graminore dhe bishtajore një dhe shumëvjeçare.
- Të përshkruajnë teknologjinë e prodhimit të farës së drithërave.
- Të përshkruajnë teknologjinë e prodhimit të farës së bimëve industriale.
- Të përshkruajnë teknologjinë e prodhimit të farës së perimeve.
- Të përshkruajnë teknologjinë e prodhimit të farës së patates.
- Të përshkruajnë teknologjinë e prodhimit të farës së jonxhës.
- Të përshkruajnë veçoritë e aprobimit të farës së bimëve bujqësore.
- Të analizojnë cilësitë e farës (pastërtia analitike e farës, fuqia dhe energjia mbirëse etj).
- Të përshkruajnë parimet dhe mënyrat e ruajtjes së prodhimit bimor.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Prodhimi bimor”, kl 12 - 136 orë**

| | | |
|---|---|---|
| **Tema 1** | Rëndësia dhe sistemet e prodhimit bimor | 3 orë |

| | | |
|---|---|---|
| **Tema 2** | Agroteknologjia e prodhimit të drithërave dhe të lashtave | 9 orë |
| **Tema 3** | Agroteknologjia e prodhimit të drithërave të vona | 8 orë |
| **Tema 4** | Sëmundjet dhe dëmtuesit e drithërave si dhe masat e luftimit të tyre | 6 orë |
| **Tema 5** | Agroteknologjia e prodhimit të bishtajore për kokërr | 8 orë |
| **Tema 6** | Sëmundjet dhe dëmtuesit e bishtajoreve për kokërr | 4 orë |
| **Tema 7** | Agroteknologjia e prodhimit të industriale vajore dhe sheqerore | 6 orë |
| **Tema 8** | Agroteknologjia e prodhimit të kulturave narkotike dhe fijore | 6 orë |
| **Tema 9** | Agroteknologjia e prodhimit të kulturave aromatike | 8 orë |
| **Tema 10** | Sëmundjet dhe dëmtuesit e bimëve industriale | 3 orë |
| **Tema 11** | Agroteknologjia e prodhimit të kulturave perimore për frute, gjethe dhe kërcell | 6 orë |
| **Tema 12** | Agroteknologjia e prodhimit të kulturave perimore për frutrrënjor, lule dhe bishtajë | 7 orë |
| **Tema 13** | Agroteknologjia e prodhimit të patates. Degjenerimi i patates. Ruajtja e prodhimit të patates | 6 orë |
| **Tema 14** | Sëmundjet dhe dëmtuesit e perimeve dhe patates | 6 orë |
| **Tema 15** | Vargëzimi i prodhimit të perimeve | 2 orë |
| **Tema 16** | Agroteknologjia e prodhimit foragjere. Bimët foragjere gramore dhe bishtajore një dhe shumëvjeçare | 6 orë |
| **Tema 17** | Sëmundjet dhe dëmtuesit e bimëve foragjere | 3 orë |
| **Tema 18** | Rëndësia e prodhimit të farave të bimëve të arave | 3 orë |
| **Tema 19** | Teknologjia e prodhimit të farave të drithërave | 8 orë |
| **Tema 20** | Teknologjia e prodhimit të farave të bimëve industriale | 4 orë |
| **Tema 21** | Teknologjia e prodhimit të farës së patatës | 3 orë |
| **Tema 22** | Teknologjia e prodhimit të farave të bimëve perimore | 9 orë |
| **Tema 23** | Teknologjia e prodhimit të farës së jonxhës | 3 orë |
| **Tema 24** | Aprobimi i farës së kulturave bujqësore | 3 orë |
| **Tema 25** | Cilësitë e farave të bimëve të bujqësore | 3 orë |
| **Tema 26** | Ruajtja e farave të bimëve bujqësore | 3 orë |

## 3. Lënda "Përpunimi i prodhimit bimor" (L-14-332-20) Kl.12 – 34 orë

- **Synimet e lëndës "Përpunimi i prodhimit bimor", kl. 12.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës "Përpunimi i prodhimit bimor", kl.12, nxënësit duhet.

– Të theksojnë rëndësinë ekonomike të përpunimit e ruajtjes së produkteve bujqësore me origjinë bimore.
– Të përshkruajnë cilësitë, klasifikimin, mjetet dhe teknologjinë e përpunimit e të ruajtjes së produkteve të drithërave.
– Të përshkruajnë cilësitë, përbërjen kimike të perimeve që përdoren si lëndë e parë në industrinë e përpunimit.
– Të përshkruajnë rëndësinë, mjetet dhe teknologjinë e përpunimit të perimeve për salcë, turshi etj.
– Të tregojnë mënyrat e ambalazhimit e të ruajtjes së prodhimeve të përpunuara të perimeve.
– Të përshkruajnë cilësitë, përbërjen kimike të bimëve vajore që përdoren si lëndë e parë në industrinë e përpunimit.

– Të përshkruajnë rëndësinë, mjetet dhe teknologjinë e përpunimit të bimëve vajore.
– Të tregojnë mënyrat e ambalazhimit, etiketimit e të ruajtjes së prodhimeve të përpunuara të bimëve vajore.
– Të përshkruajnë mënyrat e përpunimit të prodhimit foragjer si ushqim për blegtorinë.
– Të përshkruajnë mënyrat e ruajtjes së prodhimit foragjer të përpunuar.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës** “**Përpunimi i prodhimit bimor**”, **kl 12 - 34 orë**

| | | |
|---|---|---|
| **Tema 1** | Rëndësia e përpunimit dhe e ruajtjes së prodhimit bimor | 3 orë |
| **Tema 2** | Përpunimi i drithrave dhe ruajtja e produkteve të përpunuara | 9 orë |
| **Tema 3** | Përpunimi i perimeve dhe ruajtja e produkteve të përpunuara | 8 orë |
| **Tema 4** | Përpunimi i bimëve vajore dhe ruajtja e produkteve të përpunuara | 8 orë |
| **Tema 5** | Përpunimi i prodhimit foragjer për blegtori | 4 orë |
| **Tema 6** | Ruajtja e prodhimit foragjer të përpunuar | 2 orë |

## IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar

### 1. Moduli “Përgatitja e tokës për mbjelljen e kulturave të arave ”

**Drejtimi:** **Bujqësi**
**Profili:** **Prodhim bimor**
**Niveli:** **III i KSHK**
**Klasa:** **12**

| *PËRSHKRUESI I MODULIT* | | |
|---|---|---|
| **Titulli dhe kodi** | **PËRGATITJA E TOKËS PËR MBJELLJEN E KULTURAVE TË ARAVE** | **M-14-1648-20** |
| **Qëllimi i modulit** | Modul praktik që i pajis nxënësit me aftësi praktike për të kryer punimin bazë dhe plotësues të tokës për mbjellje, si dhe për të kryer llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me punimet për përgatitjen e tokës për mbjelllje. | |
| **Kohëzgjatja e modulit** | 102 orë mësimore | |
| **Niveli i parapëlqyer për pranim** | Nxënësit duhet të kenë përfunduar të kualifikimin në drejtimin mësimor “Bujqësi”, niveli II i KSHK. | |
| **Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit** | **RM 1** | **Nxënësi përgatitet për punimet e tokës për mbjellje.**<br>***Kriteret e vlerësimit.***<br>Nxënësi duhet të jetë i aftë.<br>– Të veshë uniformën dhe pajisjet e duhura mbrojtëse të punës për punimin e tokës për mbjellje<br>– Të përzgjedhë llojin e duhur të veglave e mjeteve për kryerjen e punimit të tokës.<br>– Të përcaktojë vendin ku do kryhen punimet e tokës.<br>– Të organizojë vendin e punës për kryerjen e punimeve.<br>– Të analizojë kushtet e tokës për kryerjen e punimeve.<br>– Të përcaktojë kohën e kryerjes së punimeve të tokës.<br>– Të përcaktojë dozën e plehërimit organik dhe mineral të tokës.<br>– Të përcaktojë llojin e punimit që do të kryhet.<br>– Të përcaktojë afatet e punimeve të tokës.<br>– Të plotësojë dokumentacionin teknik të punimeve të tokës.<br>– Të kujdeset siç duhet për veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për punimin e tokës.<br>– Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë parapërgatitjeve për punimin e tokës për mbjellje.<br>– Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë parapërgatitjes së tokës për mbjellje.<br>***Instrumentet e vlerësimit.*** |





– Pyetje - përgjigje me gojë
– Vëzhgim me listë kontrolli

**RM 2 Nxënësi kryen punimin bazë të tokës.**

***Kriteret e vlerësimit.***

Nxënësi duhet të jetë i aftë

- Të veshë uniformën dhe pajisjet e duhura mbrojtëse gjatë punimit bazë të tokës.
- Të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për punimit bazë të tokës.
- Të kryejë kontrollin teknik vizual të zakonshëm të veglave dhe mjeteve të punës për punimin bazë të tokës.
- Të bëjë përshtatjen e veglave dhe mjeteve të punës sipas llojit të punimit.
- Të kryejë shpërndarjen e plehërave organike dhe minerale.
- Të kryejë punimin bazë të tokës me vegla të thjeshta ose të mekanizuara sipas llojit të punimit.
- Të kontrollojë cilësinë e punimit bazë të tokës sipas llojit të punimit.
- Të pastrojë veglat dhe mjetet e punës pas përdorimit të tyre.
- Të kujdeset për veglat, pajisjet dhe materialet e punës gjatë dhe pas përdorimit të tyre.
- Të plotësojë dokumentacionin teknik për punimet bazë të tokës.
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me punimet e kryera.
- Të plotësojë faturën financiare për punimet e kryera.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë punimin bazë të tokës.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë punimin bazë të tokës.

***Instrumentet e vlerësimit.***

- Vëzhgim me listë kontrolli

**RM 3 Nxënësi kryen punimin plotësues të tokës.**

***Kriteret e vlerësimit.***

Nxënësi duhet të jetë i aftë.

- Të veshë uniformën dhe pajisjet e duhura mbrojtëse të punimeve plotësuese të tokës.
- Të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme të punimeve plotësuese të tokës.
- Të hartojë planin e kryerjes së punimeve plotësuese të tokës.
- Të kryejë kontrollin teknik vizual të zakonshëm të veglave dhe mjeteve të punës për punimet plotësuese të tokës.

| | |
|---|---|
| | – Të bëjë përshtatjen e veglave dhe mjeteve të punës llojit të punimit.<br>– Të kryejë shpërndarjen e plehrave fosforike dhe potasike.<br>– Të kryejë punimin plotësues të tokës me vegla të thjeshta ose të mekanizuara.<br>– Të kontrollojë cilësinë e punimit plotësues të tokës sipas llojit të punimeve.<br>– Të pastrojë veglat dhe mjetet e punës pas kryerjes së punimeve plotësuese të tokës.<br>– Të plotësojë dokumentacionin teknik për punimet plotësuese të tokës.<br>– Të kujdeset për veglat, pajisjet dhe materialet e punës gjatë punimeve plotësuese të tokës.<br>– Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë punimeve plotësuese të tokës.<br>– Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me punimet e kryera.<br>– Të plotësojë faturën financiare për punimet e kryera.<br>– Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punimeve plotësuese të tokës.<br>***Instrumentet e vlerësimit.***<br>– Vëzhgim me listë kontrolli |
| **Udhëzime për zbatimin e modulit** | – Ky modul mund të trajtohet në fermën e shkollës ose në ndonjë fermë, pranë shkollës sipas mundësive që ofron zona dhe rajoni ku ndodhet ajo.<br>– Gjatë trajtimit të modulit mësuesi i praktikës duhet të përdorë demostrime konkrete të përgatitjes për punimin e tokës, të punimit bazë, të punimit plotësues të tokës për mbjellje, si dhe të llogaritjeve të thjeshta ekonomike lidhur me to.<br>– Instruktori i praktikës mund të organizojë edhe vizitë mësimore në ferma të prodhimit bimor, që nxënësit të njihen konkretisht me larminë e mjeteve për përgatitjen e tokës për mbjellje.<br>– Instruktori i praktikës përfshin nxënësit në diskutim mbi përgatitjet për punimin e tokës, punimin bazë, punimin plotësues të tokës për mbjellje.<br>– Nxënësit duhet të praktikohen sa më shumë të jetë e mundur në proceset e punës për përgatitjen e tokës për mbjellje, si dhe në llogaritjet e thjeshta ekonomike lidhur me to.<br>– Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë përdorimin dhe mirëmbajtjen e veglave dhe mjeteve gjatë dhe pas kryerjes së punimeve për përgatitjen e tokës për mbjellje.<br>– Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punimeve për përgatitjen e tokës për mbjellje.<br>– Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike të përfshira në këtë modul. |

| | |
|---|---|
| **Kushtet e e domosdoshme për realizimin e modulit** | Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme.<br>– Ferma e shkollës.<br>– Traktor ose kafshë pune.<br>– Veglat e punimit të tokës: bel, shatë, lopatë, kazëm etj<br>– Mjetet e punimit të tokës; plug, disk, frezë, brana etj.<br>– Pankarta, udhëzues, katalogë, rregullore, standarde të prodhimit bimor.<br>– Pajisje kancelarie.<br>– Makina llogaritëse dore.<br>– Manualet e preventivimit dhe të zbërthimin e kostos.<br>– Përmbledhje e legjislacionit në fushën e punimeve të prodhimit bimor (kodi i punës, legjislacioni fiskal).<br>– Modele të dokumetacionit financiar dhe fiskal. |

## 2. Moduli “Mbjellja e kulturave të arave”

**Drejtimi:** **Bujqësi**
**Profili:** **Prodhim bimor**
**Niveli:** **III i KSHK**
**Klasa:** **12**

*PËRSHKRUESI I MODULIT*

| | | |
|---|---|---|
| **Titulli dhe kodi** | **MBJELLJA E KULTURAVE TË ARAVE** | **M-14-1649-20** |

**Qëllimi i modulit**

Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të zbatuar teknikat e mbjelljes së prodhimit bimor në fushë të të lashtave, të vonave, patates, foragjereve dhe perimeve, si dhe për të kryer llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me këto punime.

**Kohëzgjatja e modulit**

120 orë mësimore

**Niveli i parapëlqyer për pranim**

Nxënësit duhet të kenë përfunduar drejtimin mësimor “Bujqësi”, niveli II i KSHK, si dhe modulin “Përgatitja e tokës për mbjellje”.

**Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit**

**RM 1** **Nxënësi përgatit farën për mbjellje.**

***Kriteret e vlerësimit.***

Nxënësi duhet të jetë i aftë.

- Të veshë uniformën dhe pajisjet e duhura mbrojtëse për përgatitjen e farës për mbjellje.
- Të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për përgatitjen e farës për mbjellje.
- Të transportojë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për përgatitjen e farës për mbjellje.
- Të përcaktojë vendin ku do përgatitet fara për mbjellje.
- Të përgatitë farën për mbjellje (ndarjen dhe dezinfektimin).
- Të kujdeset për veglat, pajisjet dhe materialet e punës gjatë përgatitjes së farës për mbjellje.
- Të pastrojë vendin dhe mjetet e punës pas përgatitjes së farës për mbjellje.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë përgatitjes së farës për mbjellje.
- Të plotësojë dokumentacionin teknik gjatë përgatitjes së farës për mbjellje.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së farës për mbjellje.

***Instrumentet e vlerësimit.***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 2** **Nxënësi mbjell të lashtat.**

***Kriteret e vlerësimit.***

Nxënësi duhet të jetë i aftë.

- Të veshë uniformën dhe pajisjet e duhura mbrojtëse gjatë mbjelljes së të lashtave.
- Të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për mbjelljen e të lashtave.
- Të transportojë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për mbjelljen e të lashtave.
- Të njihet me mënyrën dhe modelet e zbërthimit të planit të realizimit të mbjelljeve të të lashtave në fushë.
- Të zbërthejë planin e mbjelljeve të fushës sipas udhëzimeve përkatëse.
- Të përllogaritë dendësinë e mbjelljes, sipas distancave dhe mënyrës së mbjelljes të të lashtave.
- Të përllogaritë sasinë e nevojshme të farës, sipas sipërfaqes së parcelës që do të mbillet me të lashta.
- Të sigurojë sasinë e farës të përllogaritur për mbjellje.
- Të kryejë piketimin e ngastrave sipas distancave të mbjelljes në rastet kur mbjellja kryhet me krah.
- Të realizojë mbjelljen sipas distancave të caktuara të mbjelljes.
- Të pastrojë vendin dhe mjetet e punës pas mbjelljes së të lashtave.
- Të kujdeset për veglat, pajisjet dhe materialet e punës pas së mbjelljes së të lashtave.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm mbjelljes së të lashtave.
- Të plotësojë dokumentacionin teknik të mbjelljes së të lashtave.
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me punimet e kryera.
- Të plotësojë faturën financiare për punimet e kryera.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë zbatimit të teknikës së mbjelljes së të lashtave.

***Instrumentet e vlerësimit.***

Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 3 Nxënësi mbjell të vonat.**

***Kriteret e vlerësimit.***

Nxënësi duhet të jetë i aftë.

- Të veshë uniformën dhe pajisjet e duhura mbrojtëse për mbjelljen e të vonave.
- Të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për mbjelljen e të vonave.
- Të transportojë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme.
- Të njihet me mënyrën dhe modelet e zbërthimit të planit të realizimit të mbjelljeve të të vonave në fushë.
- Të zbërthejë planin e mbjelljeve të të vonave në fushë sipas udhëzimeve përkatëse.

- Të përllogaritë dendësisë e mbjelljes, sipas distancave e mënyrës së mbjelljes së të vonave.
- Të përllogaritë sasisë e nevojshme të farës, sipas sipërfaqes së parcelës që do të mbillet me të vona.
- Të sigurojë sasinë e farës së përllogaritur për mbjellje.
- Të kryejë piketimin e ngastrave sipas distancave të mbjelljes të të vonave kur mbjellja kryhet me krah.
- Të realizojë mbjelljen e të vonave sipas distancave të caktuara të mbjelljes dhe mënyrës së mbjelljes.
- Të kujdeset për veglat, pajisjet dhe materialet e punës gjatë mbjelljes të të vonave.
- Të pastrojë vendin dhe mjetet e punës pas kryerjes së mbjelljes të të vonave.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë mbjelljes të të vonave.
- Të plotësojë dokumentacionin teknik të mbjelljes së të vonave.
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me punimet e kryera.
- Të plotësojë faturën financiare për punimet e kryera.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë mbjelljes së të vonave.

***Instrumentet e vlerësimit.***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 4 Nxënësi mbjell patate.**

***Kriteret e vlerësimit.***

Nxënësi duhet të jetë i aftë.

- Të veshë uniformën dhe pajisjet e duhura mbrojtëse për mbjelljen e patates në fushë.
- Të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për mbjelljen e patates në fushë.
- Të transportojë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme.
- Të njihet me mënyrën dhe modelet e zbërthimit të planit të realizimit të mbjelljeve të patates në fushë.
- Të zbërthejë planin e mbjelljeve së patateve sipas udhëzimeve përkatëse me brazda, gropa.
- Të përllogaritë dendësisë e mbjelljes, sipas distancave e mënyrës së mbjelljes, së patateve.
- Të përllogaritë sasinë e nevojshme të farës/zhardhokëve, sipas mënyrës së mbjelljes.
| **Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit** | **RM 1** | **Nxënësi përgatit farën për analizë.**<br>***Kriteret e vlerësimit.***<br>Nxënësi duhet të jetë i aftë.<br>– Të veshë uniformën e duhur të punës për përgatitjen e farës për analizë.<br>– Të njesojë preventivin e materilave dhe kostot për materialet e nevojshme për kryerjen e analizës së farës.<br>– Të përzgjedhë mjetet dhe materialet për përgatitjen e farës për analizë si: fara të kulturave të ndryshme, peshore me gurë deri në miligram peshe, letër të bardhë, pambuk etj.<br>– Të përgatitë mjetet dhe materialet e punës për përgatitjen e farës për analizë.<br>– Të përzgjedhë llojet e kulturave për analizën e farës së tyre si grurë, misër, jonxhë etj.<br>– Të sigurojë larminë dhe sasisë e nevojshme të farave sipas kulturave të përzgjedhura dhe mundësive që ofron zona.<br>– Të marrë mostrat e farës për analizë në peshën 50 gr për çdo lloj kulture.<br>– Të etiketojë të gjitha mostrat e farës sipas kulturës së përzgjedhur me të gjitha të dhënat përkatëse si: data e marrjes, lloji i farës, vendi ku është marrë mostra dhe | |

viti i riprodhimit të farës etj.

- Të transportojë pa dëmtuar mostrat e farës për analizë në laborator apo klasë.
- Të hapë mostrat e farës mbi një letër të bardhë apo celefon të pastër.
- Të kujdeset siç duhet për veglat, pajisjet dhe materialet e punës gjatë përgatitjes së farës për analizë.
- Të pastrojë vendin dhe mjetet e punës pas përgatitjes së farës për analizë.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë përgatitjes së farës për analizë.
- Të plotësojë dokumentacionin teknik gjatë përgatitjes së farës për analizë.
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me punimet e përgatitjes së farës për analizë.
- Të plotësojë faturën financiare të punës së kryer.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së farës për analizë.

***Instrumentet e vlerësimit.***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 2 Nxënësi analizon pastërtinë e farës.**

***Kriteret e vlerësimit.***

Nxënësi duhet të jetë i aftë.

- Të veshë uniformën dhe pajisjet e duhura mbrojtëse gjatë analizës së pastërtisë së farës për mbjellje.
- Të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për analizën e pastërtisë së farës për mbjellje.
- Të transportojë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme.
- Të përgatitë mjetet e nevojshme për analizën e pastërtisë mekanike të farës për mbjellje.
- Të veçojë lëndët e huaja pa jetë nga farat si: kashtë, hala, pluhur, fara të coptuara e të dëmtuara etj.
- Të peshojë dhe llogaritë saktë në % sasinë e lëndëve të huaja pa jetë.
- Të veçojë lëndët të huaja me jetë nga farat si: fara të bimëve të tjera elb, thekër, farat e barishteve të këqija, dëmtuesit e gjallë dhe larvat e tyre etj.
- Të peshojë dhe llogaritë saktë në % sasinë së lëndëve të huaja me jetë.
- Të veçojë farat e pazhvilluara mire si: ato me embrion jo të plotë, të mpita dhe me endospermë të dëmtuar pjesërisht.
- Të peshojë dhe llogaritë saktë në % sasisë së farave të pazhvilluara mirë.
- Të veçojë me kujdes farat e plota dhe të shëndetshme.
- Të peshojë dhe llogaritë saktë në % sasinë e farave të

plota dhe të shëndetshme.
- Të përcaktojë pastërtinë e farës dhe klasën e saj, sipas llojit të farës.
- Të krahasojë rezultatin e analizës me rezultatet e tabelës së klasifikimit të farave.
- Të vlerësojë farën për mbjellje ose jo, duke iu referuar standardit të farave.
- Të pastrojë vendin dhe mjetet e punës pas analizës së pastërtisë së farës për mbjellje.
- Të kujdeset siç duhet për veglat, pajisjet dhe materialet e punës gjatë analizës së pastërtisë së farës për mbjellje.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë analizës së pastërtisë së farës për mbjellje.
- Të plotësojë dokumentacionin teknik gjatë analizës së pastërtisë së farës për mbjellje.
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me analizën e pastërtisë së farës për mbjellje.
- Të plotësojë faturën financiare të punës së kryer.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë analizës së pastërtisë së farës për mbjellje.

***Instrumentet e vlerësimit.***
- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 3 Nxënësi analizon energjinë dhe fuqinë mbirëse të farës.**

***Kriteret e vlerësimit.***

Nxënësi duhet të jetë i aftë.
- Të veshë uniformën dhe pajisjet e duhura mbrojtëse gjatë analizimit të energjisë dhe fuqisë mbirëse të farës për mbjellje.
- Të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për analizimin e energjisë dhe fuqisë mbirëse të farës për mbjellje.
- Të transportojë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme.
- Të përgatitë mjetet e nevojshme për analizën e energjisë dhe fuqisë mbirëse të farës për mbjellje.
- Të marrë mostrat e farës për 4 prova analize: farat e mëdha me nga 100 fara, të voglat me 50 fara.
- Të njomë mostrat e farës me ujë, për mbirje.
- Të vendosë mostrën e farës në shtrat me rërë ose letër thithëse në pjata sipas kritereve të përcaktuara për mbirje.
- Të vendosë në dollap ose në termostat në temperaturë të caktuar, mostrat e farës, për çdo lloj bime.
- Të mbajë mostrat e farave në dollap për 3-4 ditë për të përcaktuar energjinë mbirëse.
- Të përcaktojë energjinë mbirëse të farës duke nxjerrë pjatat nga dollapi dhe numëruar farat e mbira pas 3-4 ditësh.
- Të mbajë mostrat në dollap për 7-10 ditë për të përcaktuar





| | |
|---|---|
| | fuqinë mbirëse të farës.<br>– Të përcaktojë fuqisë mbirëse duke nxjerrë pjatat nga dollapi dhe numëruar farat e mbira me kujdes.<br>– Të vlerësojë farën për mbjellje ose jo duke u bazuar në rezultatet e analizës.<br>– Të kujdeset siç duhet për veglat, pajisjet dhe materialet e punës gjatë analizës së energjisë dhe fuqisë mbirëse të farës për mbjellje.<br>– Të pastrojë vendin dhe mjetet e punës pas analizës së energjisë dhe fuqisë mbirëse të farës për mbjellje.<br>– Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë analizës së energjisë dhe fuqisë mbirëse të farës për mbjellje.<br>– Të plotësojë dokumentacionin teknik gjatë analizës së energjisë dhe fuqisë mbirëse të farës për mbjellje.<br>– Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me analizën e energjisë dhe fuqisë mbirëse të farës për mbjellje.<br>– Të plotësojë faturën financiare të punës së kryer.<br>– Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë analizës së energjisë dhe fuqisë mbirëse të farës për mbjellje.<br>***Instrumentet e vlerësimit.***<br>– Vëzhgim me listë kontrolli. |
| **Udhëzime për zbatimin e modulit** | – Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në laboratorin e shkollës ose në klasë.<br>– Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete të proceseve të punës për përgatitjen e farës për analizë, analizën e pastërtisë mekanike, energjisë dhe fuqisë mbirëse të farës për mbjellje.<br>– Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për përgatitjen e farës për analizë, analizën e pastërtisë, energjisë dhe fuqisë mbirëse të farës për mbjellje.<br>– Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë përdorimin dhe mirëmbajtjen e veglave, mjeteve dhe materialeve të përgatitjes së farës për analizë, analizën e pastërtisë, energjisë dhe fuqisë mbirëse të farës për mbjellje.<br>– Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së farës për analizë, analizën e pastërtisë, energjisë dhe fuqisë mbirëse të farës për mbjellje.<br>– Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës të përgatitjes së farës për analizë, analizën e pastërtisë, energjisë dhe fuqisë mbirëse të farës për mbjellje. |

| | |
|---|---|
| **Kushtet e e domosdoshme për realizimin e modulit** | Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme.<br>– Laboratori me pajisjet e duhura për analizën e farës.<br>– Pjata me letër thithëse.<br>– Rërë.<br>– Fara të kulturave të ndryshme.<br>– Dollap, termostat.<br>– Pajisje kancelarie.<br>– Makina llogaritëse dore.<br>– Pankarta, tabela apo katalogë të klasifikimit të farave për mbjellje etj. |

## 2.Moduli “Prodhimi i vajit nga kulturat vajore”

**Drejtimi:** **Bujqësi**
**Profili:** **Prodhim bimor**
**Niveli:** **III i KSHK**
**Klasa:** **12**

*PËRSHKRUESI I MODULIT*

| | | |
|---|---|---|
| **Titulli dhe kodi** | **PRODHIMI I VAJIT NGA KULTURAT VAJORE** | **M-08-1652-20** |
| **Qëllimi i modulit** | Një modul praktik që aftëson nxënësit për të kryer përpunimin e farave për prodhimin e vajit me ekstraktim, me presim, ambalazhimin dhe ruajtjen e vajit të prodhuar, si dhe për të kryer llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me këto procese pune. | |
| **Kohëzgjatja e modulit** | 51 orë mësimore | |
| **Niveli i parapëlqyer për pranim** | Nxënësi duhet të ketë përfunduar niveli II të KSHK në drejtimin mësimor “Bujqësi”. | |
| **Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe proçedurat e vlerësimit** | **RM 1** | **Nxënësi përgatitet për prodhimin e vajit.**<br>***Kriteret e vlerësimit.***<br>Nxënësi duhet të jetë i aftë.<br>– Të veshë uniformën dhe pajisjet e duhura mbrojtëse gjatë përgatitjes për prodhimin e vajit.<br>– Të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për prodhimin e vajit.<br>– Të transportojë veglat, pajisjet e materialet e nevojshme.<br>– Të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për për prodhimin e vajit.<br>– Të higjienizojë vendin dhe mjetet e punës, sipas rregullave higjieno-sanitare.<br>– Të përzgjedhë llojin e kulturës vajore për prodhimin e vajit (lulediellі, kikirik, misër etj.)<br>– Të transportojë lëndën e parë në repartin e përgatitjes së saj.<br>– Të furnizojë bunkerin me lëndën e parë, pa e derdhur atë.<br>– Të transportojë farat e ku;turës në pajisjet tharëse.<br>– Të mbikqyrë, me kujdes, temperaturën gjatë procesit të tharjes, për mosndryshim të saj.<br>– Të transportojë, me kujdes, farat e luledielllit në pajisjet e pastrimit.<br>– Të largojë mbeturinat nga reparti.<br>– Të transportojë lëndën e parë në pajisjet copëtuese.<br>– Të pastrojë vendin dhe mjetet e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare.<br>– Të kujdeset siç duhet për veglat, pajisjet dhe materialet e |

punës gjatë përgatitjes për prodhimin e vajit.

- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë përgatitjes për prodhimin e vajit.
- Të plotësojë dokumentacionin teknik gjatë përgatitjes për prodhimin e vajit.
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me përgatitjen për prodhimin e vajit.
- Të plotësojë faturën financiare të punës së kryer.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë përgatitjes për prodhimin e vajit.

***Instrumentet e vlerësimit.***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 2 Nxënësi kryen procese pune për prodhimin e vajit me ekstraktim.**

***Kriteret e vlerësimit.***

Nxënësi duhet të jetë i aftë.

- Të veshë uniformën dhe pajisjet e duhura mbrojtëse gjatë kryerjes së proceseve të punës për prodhimin e vajit.
- Të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për kryerjen e proceseve të punës për prodhimin e vajit.
- Të transportojë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme.
- Të përgatisë vendin dhe mjetet e punës, për prodhimin e vajit me ekstraktim.
- Të higjienizojë mjetet dhe mjedisin e punës, sipas kushteve higjieno-sanitare.
- Të transportojë, me kujdes, lëndën e parëtë të copëtuar në repart.
- Të transportojë tretësirën në repart.
- Të mbushë ekstraktorët me lëndën e parë të copëtuar.
- Të mbyllë hermetikisht ekstraktorët.
- Të mbikqyrë temperaturën gjatë procesit të distilimit të përzierjes vaj-tretës, për të ruajtur temperaturën konstante.
- Të masë nivelin e tretësit në rezervuar.
- Të shkarkojë pa ndotur ambientin, bërsitë nga ekstraktorët.
- Të transportojë bërsitë nga reparti.
- Të pastrojë vendin dhe mjetet e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare.
- Të kujdeset siç duhet për veglat, pajisjet dhe materialet e punës gjatë kryerjes së proceseve të punës për prodhimin e vajit me ekstraktim.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë kryerjes së proceseve të punës për prodhimin e vajit me ekstraktim.
- Të plotësojë dokumentacionin teknik të prodhimit të vajit me ekstraktim.

– Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me proceset e punës për prodhimin e vajit me ekstraktim.
– Të plotësojë faturën financiare për punën e kryer.
– Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë kryerjes së proceseve të punës të prodhimit të vajit me ekstraktim.

***Instrumentet e vlerësimit.***

– Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 3 Nxënësi kryen procese pune për prodhimin e vajit me presim.**

***Kriteret e vlerësimit.***

Nxënësi duhet të jetë i aftë.

– Të veshë uniformën dhe pajisjet e duhura mbrojtëse gjatë kryerjes së proceseve të punës për prodhimin e vajit me presim.
– Të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për kryerjen e proceseve tëpunës për prodhimin e vajit me presim.
– Të transportojë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme.
– Të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për prodhimin e vajit me presim.
– Të higjienizojë mjetet dhe mjedisin e punës sipas kërkesave higjieno-sanitare.
– Të transportojë lëndën e parë të copëtuar në repartin e presimit.
– Të furnizojë me shumë kujdes presën me lëndën e parë të copëtuar.
– Të shkarkojë bërsitë nga presa, pa ndotur mjedisin ku punohet.
– Të transportojë me kujdes bërsitë nga reparti në vendin e duhur.
– Të pastrojë vendin dhe mjetet e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare.
– Të kujdeset siç duhet për veglat, pajisjet dhe materialet e punës, kryerjes së proceseve të punës për prodhimin e vajit me presim.
– Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë kryerjes së proceseve të punës për prodhimin e vajit me presim.
– Të plotësojë dokumentacionin teknik të prodhimit të vajit me presim.
– Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me proceset e punës për prodhimin e vajit me presim.
– Të plotësojë faturën financiare për punën e kryer.
– të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë kryerjes së proceseve të punës për prodhimin e vajit me presim.

***Instrumentet e vlerësimit.***

– Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 4 Nxënësi kryen ambalazhimin dhe ruajtjen e vajit të prodhuar.**

***Kriteret e vlerësimit.***

Nxënësi duhet të jetë i aftë.

- Të veshë uniformën dhe pajisjet e duhura mbrojtëse për ambalazhimin dhe ruajtjen të vajit të prodhuar.
- Të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për ambalazhimin dhe ruajtjes e vajit të prodhuar.
- Të transportojë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme.
- Të përgatisë vendin dhe mjetet e punës, për ambalazhimin dhe ruajtjen e vajit të prodhuar.
- Të higjienizojë mjetet dhe mjedisin e punës, sipas kërkesave higjieno-sanitare.
- Të përgatisë ambalazhet bosh, për mbushje, sipas standardeve të kërkuara.
- Të mbikqyrë mbushjen e ambalazheve me vaj.
- Të taposë shishet e mbushura me vaj.
- Të etiketojë ambalazhet me etiketat përkatëse, sipas kritereve të marketingut.
- Të vendosë vajin e ambalazhuar në kuti, pa e dëmtuar.
- Të transportojë produktin e ambalazhuar në magazinë.
- Të pastrojë vendin dhe mjetet e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare.
- Të kujdeset siç duhet për veglat, pajisjet dhe materialet e punës gjatë ambalazhimit dhe ruajtjes së vajit të prodhuar.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë kryerjes së ambalazhimit dhe ruajtjes së vajit të prodhuar.
- Të plotësojë dokumentacionin teknik të ambalazhimit dhe ruajtjes së vajit të prodhuar.
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me proceset e punës për ambalazhimin dhe ruajtjen e vajit të prodhuar.
- Të plotësojë faturën financiare për punën e kryer për ambalazhimin dhe ruajtjen e vajit të prodhuar.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë ambalazhimit dhe ruajtjes së vajit.

***Instrumentet e vlerësimit.***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

| | |
|---|---|
| **Udhëzime për zbatimin e modulit** | – Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në repartet e përpunimit për prodhimin e vajit ose në frabrikë të prodhimit të vajit.<br>– Gjatë trajtimit të modulit instruktori i praktikës, ose teknologu i repartit duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete të proceseve të punës për përpunimin e lëndës së parë, prodhimit të vajit me ekstraktim dhe me presim, ambalazhimit dhe ruajtjes së vajit , si dhe llogaritjeve të |

| | |
|---|---|
| | thjeshta ekonomike lidhur me proceset e punës për prodhimin e vajit.<br>– Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtaritë konkrete të punës për kryerjen e proceseve të punës për përpunimin e lëndës së parë, prodhimit të vajit me ekstraktim, dhe me presim, ambalazhimit dhe ruajtjes së vajit, si dhe llogaritjeve të thjeshta ekonomike lidhur me proceset e punës për prodhimin e vajit.<br>– Instruktori i praktikës ose teknologu i repartit duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së makinerive e pajisjeve.<br>– Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike të përfshira në modul. |
| **Kushtet e e domosdoshme për realizimin e modulit** | Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme.<br>– Repart për prodhimin e vajit.<br>– Mjete pune për prodhimin e vajit, ambalazhimit dhe ruajtjes së tij.<br>– Lëndë të para për prodhimin e vajit.<br>– Skema, makete, udhëzuesa, katalog, rregullore, standarde shtetërore, etj.<br>– Pajisje kancelarie.<br>– Makina llogaritëse dore.<br>– Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.<br>– Përmbledhje e legjislacionit në fushën e përpunimit të farave për vaj (kodi i punës, legjislacioni fiskal).<br>– Modele të dokumetacionit financiar dhe fiskal. |

**3. Moduli "Ujitja e bimëve të arave dhe perimeve"**

**Drejtimi:** **Bujqësi**
**Profili:** **Prodhim bimor**
**Niveli:** **III i KSHK**
**Klasa:** **12**

| *PËRSHKRUESI I MODULIT* | | | |
|---|---|---|---|
| **Titulli dhe kodi** | **UJITJA E BIMËVE TË ARAVE E PERIMEVE** | | **M-14-947-20** |
| **Qëllimi i modulit** | Një modul praktik që i aftëson nxënësit për kryerjen e ujitjes sipërfaqësore me brazda e rrëshqitje, me shihedhje dhe me pika, si dhe për të kryer llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me këto procese pune. | | |
| **Kohëzgjatja e modulit** | 51 orë mësimore | | |
| **Niveli i parapëlqyer për pranim** | Nxënësi duhet të ketë përfunduar drejtimin mësimor të drejtimit "Bujqësi", niveli II i KSHK. | | |
| **Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit** | **RM 1** | **Nxënësi kryen punime përgatitore për ujitjen me mënyra të ndryshme.**<br>***Kriteret e vlerësimit.***<br>Nxënësi duhet të jetë i aftë.<br>– Të veshë uniformën dhe pajisjet e duhura mbrojtëse gjatë kryerjes së punimeve përgatitore për ujitjen me mënyra të ndryshme.<br>– Të përzgjedhë veglat, pajisjet për kryerjen e ujitjeve sipas kulturës dhe mënyrës së ujitjes.<br>– Të përcaktojë tokën e mbjellë për ujitje sipas kulturave.<br>– Të transportojë veglat dhe pajisjet në vendin e caktuar.<br>– Të interpretojë dhe skicojnë sipas skicave të gatshme për ujitjen e tokës.<br>– Të përcaktojë kohën dhe mënyrën e duhur të ujitjes sipas llojit të kulturës, tipit dhe pjerrësisë së tokës bujqësore.<br>– Të pastrojë vendin dhe mjetet e punës pas kryerjes së punimeve përgatitore për ujitjen me mënyra të ndryshme.<br>– Të kujdeset siç duhet për veglat, pajisjet dhe materialet e punës gjatë kryerjes së punime përgatitore për ujitjen me mënyra të ndryshme.<br>– Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë kryerjes së punimeve përgatitore për ujitjen me mënyra të ndryshme.<br>– Të plotësojë dokumentacionin teknik të punimeve | |

përgatitore për ujitjen me mënyra të ndryshme.

- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me punimet përgatitore për ujitjen me mënyra të ndryshme.
- Të plotësojë faturën financiare për punën e kryer.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punimeve përgatitore për ujitjen me mënyra të ndryshme.

***Instrumentet e vlerësimit.***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 2 Nxënësi kryen ujitje sipërfaqësore me brazda e rrëshqitje.**

***Kriteret e vlerësimit.***

Nxënësi duhet të jtë i aftë.

- Të veshë uniformën dhe pajisjet e duhura mbrojtëse gjatë kryerjes së ujitjes sipërfaqësore me brazda e rrëshqitje.
- Të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për kryerjen e ujitjes sipërfaqësore me brazda e rrëshqitje.
- Të transportojë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme.
- Të përcaktojë kulturën që i përshtatet ujitjes sipërfaqësore me brazda e rrëshqitje.
- Të përcaktojë gjerësinë dhe largësinë e brazdave sipas llojit të tokës.
- Të hapin brazdat duke zbatuar parametrat teknikë sipas përbërjes mekanike, pjerrësisë së tokës etj.
- Të lëshojë ujin në brazdë me një rrymë fillestare të caktuar për të mbërritur sa më shpejt në fund të saj.
- Të përcaktojë kohën e qëndrimit të ujit në brazdë sipas përbërjes grimcametrike të tokës.
- Të ndjekë lëvizjen e ujit në brazdë sipas drejtimit të mbjelljes së bimëve.
- Të kryejë ujitjen sipërfaqësore me rrëshqitje sipas pjerrësisë së tokës.
- Të kontrollojë cilësinë e ujitjes sipërfaqësore me brazda e rrëshqitje për plotësimin e kërkesave teknike.
- Të kujdeset siç duhet për veglat, pajisjet dhe materialet e punës gjatë kryerjes së ujitjes sipërfaqësore me brazda e rrëshqitje.
- Të pastrojë vendin dhe mjetet e punës pas ujitjes sipërfaqësore me brazda dhe rrëshqitje.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë kryerjes së ujitjes sipërfaqësore me brazda e rrëshqitje.
- Të plotësojë dokumentacionin teknik të punimeve përgatitore për ujitjen sipërfaqësore me brazda e rrëshqitje.

- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me ujitjen sipërfaqësore me brazda e rrëshqitje.
- Të plotësojë faturën financiare për punën e kryer.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së ujitjes sipërfaqësore me brazda e rrëshqitje.

***Instrumentet e vlerësimit.***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 3 Nxënësi kryen ujitjen me shihedhje.**

***Kriteret e vlerësimit.***

Nxënësi duhet të jetë i aftë.

- Të veshë uniformën dhe pajisjet e duhura mbrojtëse gjatë kryerjes së ujitjes me shihedhje.
- Të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për kryerjen e ujitjes me shihedhje.
- Të transportojë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme.
- Të përzgjedhë kulturën që i përshtatet ujitjes me shihedhje.
- Të kontrollojë impiantin shihedhës për funksionim të rregullt të tij.
- Të montojë impiantin ujitës sipas kërkesave teknike.
- Të lëshojë ujin në mënyrë të njëtrajtshme për mbulimin e të gjithë sipërfaqes.
- Të kontrollojë në mënyrë të vazhdueshme kryerjen e ujitjes për evitimin e rrjedhjeve nga tubacionet.
- Të çmontojë impiantin ujitës sipas kërkesave teknike.
- Të pastrojë dhe mirëmbajnë impiantin ujitës sipas kërkesave teknike.
- Të kujdeset siç duhet për veglat, pajisjet dhe materialet e punës gjatë kryerjes së ujitjes me shihedhje.
- Të pastrojë vendin dhe mjetet e punës pas kryerjes së ujitjes me shihedhje.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë kryerjes së ujitjes me shihedhje.
- Të plotësojë dokumentacionin teknik të kryerjes së ujitjes me shihedhje.
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me kryerjen e ujitjes me shihedhje.
- Të plotësojë faturën financiare për punën e kryer.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së ujitjes me shihedhje.

***Instrumentet e vlerësimit.***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 4 Nxënësi kryen ujitjen me pika**.

| | |
|---|---|
| | ***Kriteret e vlerësimit.***<br>Nxënësi duhet të jetë i aftë.<br>– Të veshë uniformën dhe pajisjet e duhura mbrojtëse gjatë kryerjes së ujitjes me pika.<br>– Të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për kryerjen e ujitjes me pika.<br>– Të transportojë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme.<br>– Të përzgjedhë kulturën që i përshtatet ujitjes me pika.<br>– Të përzgjedhë pikatoret e duhura në varësi të kulturës dhe t'i transportojnë ato.<br>– Të montojë pikatoret në tubacione sipas kushteve teknike.<br>– Të përcaktojë normën e ujitjes sipas formulës së dhënë.<br>– Të lëshojë ujin në mënyrë të njëtrajtshme për mbulimin e të gjithë sipërfaqes.<br>– Të kontrollojë në mënyrë të vazhdueshme ujitjen me pika për evitimin e rrjedhjeve nga tubacionet.<br>– Të çmontojë tubat e çmontueshëm dhe pikatoret sipas kushteve teknike.<br>– Të pastrojë dhe mirëmbajë pikatoret sipas kërkesave teknike.<br>– Të kujdeset siç duhet për veglat, pajisjet dhe materialet e punës gjatë kryerjes së ujitjes me pika.<br>– Të pastrojë vendin dhe mjetet e punës pas kryerjes së ujitjes me pika.<br>– Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë kryerjes së ujitjes me pika.<br>– Të plotësojë dokumentacionin teknik të kryerjes së ujitjes me pika.<br>– Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me kryerjen e ujitjes me pika.<br>– Të plotësojë faturën financiare për punën e kryer.<br>– Të zbatojë rregullat e sigurimin teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë ujitjes me pika.<br>***Instrumentet e vlerësimit.***<br>– Vëzhgim me listë kontrolli. |
| **Udhëzime për zbatimin e modulit** | Ky modul duhet të trajtohet në bazën prodhuese të shkollës ose në ferma bujqësore të cilat praktikojnë mënyra të ndryshme të ujitjes.<br>– Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete të proceseve të ujitjes sipërfaqësore me brazda e rrëshqitje, me shihedhje dhe me pika, si dhe të llogaritjeve të thjeshta ekonomike lidhur me to.<br>– Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve për ujitjen sipërfaqësore me brazda |

| | |
|---|---|
| | e rrëshqitje, me shihedhje dhe me pika, si dhe të llogaritjeve të thjeshta ekonomike lidhur me to.<br>– Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë përdorimin dhe mirëmbajtjen e veglave, mjeteve dhe impianteve për ujitjen sipërfaqësore me brazda e rrëshqitje, me shihedhje dhe me pika si dhe të llogaritjeve të thjeshta ekonomike lidhur me to.<br>– Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së veglave, pajisjeve dhe impjanteve.<br>– Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për ujitjen sipërfaqësore me brazda e rrëshqitje, me shihedhje dhe me pika si dhe të llogaritjeve të thjeshta ekonomike lidhur me to. |
| **Kushtet e e domosdoshme për realizimin e modulit** | Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen terreni, veglat dhe pajisjet e punës të mëposhtme.<br>– Skica të gatshme me skema për rrjetin e ujitjes sipërfaqësore me brazda, me shihedhje dhe me pika.<br>– Impiant për ujitjen me shihedhje dhe me pika,<br>– Tubacione, etj.<br>– Pajisje kancelarie.<br>– Makina llogaritëse dore.<br>– Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.<br>– Modele të dokumetacionit financiar dhe fiskal. |

## 4. Moduli “Prodhimi i farës së perimeve”

**Drejtimi:** **Bujqësi**
**Profili:** **Prodhim bimor**
**Niveli:** **III i KSHK**
**Klasa:** **12**

| *PËRSHKRUESI I MODULIT* | | |
|---|---|---|
| **Titulli dhe kodi** | PRODHIMI I FARËS SË PERIMEVE | **M-14-1653-20** |
| **Qëllimi i modulit** | Një modul praktik që i aftëson nxënësit për prodhimin e farave të perimeve, si dhe për të kryer llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me këto procese pune. | |
| **Kohëzgjatja e modulit** | 51 orë mësimore | |
| **Niveli i parapëlqyer për pranim** | Nxënësi duhet të ketë përfunduar drejtimin mësimor “Bujqësi”, niveli II i KSHK, si dhe modulet “Përgatitja e tokës për mbjellje” dhe “Mbjellja e kulturave të arave. | |

| | | |
|---|---|---|
| **Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit** | **RM 1** | **Nxënësi përgatit tokën për mbjelljen e perimeve për prodhim fare.**<br>***Kriteret e vlerësimit.***<br>Nxënësi duhet të jetë i aftë.<br>– Të veshë uniformën dhe pajisjet e duhura mbrojtëse gjatë punimit bazë dhe plotësues të tokës.<br>– Të përzgjedhë veglat, pajisjet për kryerjen e punimit bazë dhe plotësues sipas kulturës.<br>– Të përcaktojë tokën e mbjellë për punimeve sipas kulturave.<br>– Të përgatisë veglat dhe pajisjet e punës për kryerjen e punimeve.<br>– Të transportojë veglat dhe pajisjet në vendin e caktuar.<br>– Të pastrojë tokën nga gurët dhe mjetet e tjera të forta.<br>– Të kryejë sistemimin dhe nivelimin e tokës.<br>– Të kryejë punimin bazë dhe plehërimin të tokës.<br>– Të kryejë punimet plotësuese të tokës.<br>– Të kujdeset siç duhet për veglat, pajisjet dhe materialet e punës gjatë punimit bazë dhe plotësues të tokës.<br>– Të pastrojë veglat dhe mjetet e punës pas punimeve të tokës.<br>– Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë punimit bazë dhe plotësues të tokës.<br>– Të plotësojë dokumentacionin teknik të kryerjes së përgatitjes së tokës për mbjelljen e perimeve për prodhim fare.<br>– Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me |

përgatitjen e tokës për mbjelljen e perimeve për prodhim fare.
- Të plotësojë faturën financiare për punën e kryer.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punimeve bazë dhe plotësues të tokës për mbjellje të perimeve për prodhim fare.

***Instrumentet e vlerësimit.***
- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 2 Nxënësi kryen mbjelljen e perimeve për prodhim fare.**

***Kriteret e vlerësimit.***

Nxënësi duhet të jetë i aftë.
- Të veshë uniformën dhe pajisjet e duhura mbrojtëse gjatë mbjelljes së perimeve për prodhim fare.
- Të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për mbjelljen e perimeve për prodhim fare.
- Të transportojë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme.
- Të përcaktojë kulturën që do të mbillet.
- Të përcaktojë distancat e mbjelljes së bimëve.
- Të kryejë piketimin e parcelës  sipas distancave të mbjelljes.
- Të izolojë parcelën për prodhimin e farës nga parcelat e prodhimit të zokonshëm.
- Të ndërtojë brezat mbrojtëse nga erërat dhe insektet që të pengojë pjalmimin nga bimët e tjera.
- Të kryejë mbjelljen e farave ose fidanëve sipas standartit të mbjelljes.
- Të kryejë ujitje pas mbjelljes së farave dhe fidanëve.
- Të kryejë prashitjet dhe plehërimin plotësues gjatë vegjetacionit.
- Të eleminojë bimët e huaja ose të papërshtatshme që nuk janë tipike të kultivarit.
- Të kontrollojë në mënyrë të vazhdueshme gjendjen shëndetësore të bimëve.
- Të kujdeset siç duhet për veglat, pajisjet dhe materialet e punës gjatë mbjelljes së perimeve për prodhimin e farës.
- Të pastrojë vendin dhe mjetet e punës pas mbjelljes së perimeve për prodhimin e farës.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë mbjelljes së perimeve për prodhimin e farës.
- Të plotësojë dokumentacionin teknik të mbjelljes së perimeve për prodhimin e farës.
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me mbjelljen e perimeve për prodhimin e farës.
- Të plotësojë faturën financiare për punën e kryer.

– Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë mbjelljes së perimeve për prodhimin e farës.

***Instrumentet e vlerësimit.***

– Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 3 Nxënësi prodhon dhe ruan farën e perimeve.**

***Kriteret e vlerësimit.***

Nxënësi duhet të jetë i aftë.

– Të veshë uniformën dhe pajisjet e duhura mbrojtëse të prodhimit dhe ruajtjes së farës së perimeve.
– Të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për nxjerrjen e farave nga frutat, paketimit dhe ruajtjes së tyre.
– Të transportojë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme.
– Të përzgjedhë kulturën, bimët që do të merren frutat.
– Të përcaktojë vendin dhe pozicionin e marrjes së frutave në bimë.
– Të kryejë vjeljen e frutave me dorë.
– Të kryejë nxjerrjën e farave me mënyra të ndryshme.
– Të kryejë pastrimin dhe eleminimin e farave të vogla, të dëmtuara ose të papjekura.
– Të kryejë tharjen e farave në temperatura të caktuara sipas standartit.
– Të kryejë seleksionimin e farave të papërshtatshme.
– Të ambalazhojë farën e prodhuar sipas standardit.
– Të etiketojë mbi ambalazh të gjithë treguesit e farës (emrin e kultivarit, fuqinë mbirëse, aftësinë mbirëse, pastërtinë analitike).
– Të kryejë ruajtjen e farës së prodhuar në kushte të përshtatshme të ruajtjes.
– Të kujdeset për veglat, pajisjet dhe materialet e punës gjatë prodhimit dhe ruajtjes së farës sëprodhuar të perimeve.
– Të pastrojë vendin dhe mjetet e punës gjatë nxjerrjes, paketimit dhe ruajtjes së farës.
– Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë prodhimit dhe ruajtjes së farës.
– Të plotësojë dokumentacionin teknik të kryerjes së prodhimit dhe ruajtjes së farës.
– Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me prodhimin dhe ruajtjen e farës.
– Të plotësojë faturën financiare për punën e kryer.
– Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë prodhimit dhe ruajtjes së farës së perimeve.

***Instrumentet e vlerësimit.***

– Vëzhgim me listë kontrolli.

| | |
|---|---|
| **Udhëzime për zbatimin e modulit** | – Ky modul duhet të trajtohet në fermën e shkollës ose në ferma bujqësore pranë shkollës.<br>– Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete të proceseve të prodhimit të farës së perimeve të ndryshme, si dhe të llogaritjeve të thjeshta ekonomike lidhur me to.<br>– Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve për prodhimin e farës së perimeve në kushtet e fermës bujqësore, si dhe të llogaritjeve të thjeshta ekonomike lidhur me to.<br>– Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë përdorimin dhe mirëmbajtjen e veglave, mjeteve që përdoren gjatë prodhimit të farës, si dhe të llogaritjeve të thjeshta ekonomike lidhur me to.<br>– Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së veglave, pajisjeve gjatë prodhimit të farës së perimeve.<br>– Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike tëpërfshira në këtë modul. |
| **Kushtet e e domosdoshme për realizimin e modulit** | Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen terreni, veglat dhe pajisjet e punës të mëposhtme.<br>– Pankarta, skica, udhëzues, katalogë, rregullore, etj<br>– Manuale për teknika të ndryshme të prodhimit të farave.<br>– Fara të bimëve të ndryshme.<br>– Fidanë.<br>– Qese të vogla për ambalazhimin e farave.<br>– Etiketa shoqëruese dhe treguese.<br>– Vegla dhe pajisje për punimin e tokës.<br>– Rafte për vendosjen dhe ruajtjen e farave.<br>– Pajisje kancelarie.<br>– Makina llogaritëse dore.<br>– Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.<br>– Modele të dokumetacionit financiar dhe fiskal. |



